

UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN
ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË



REZULTATET PËRMBLEDHËSE TË
VLERËSIMIT PËR SEMESTRIN VEROR 2022-2023

2023

Përmbajtja

Hyrje	1
A1 – Vlerësimi i mësimeve/asistentit nga studentët	2
A2 – Vlerësimi ndërkolegjial.....	14
A3 – Raporti i vlerësimit nga dekani	17
A6 – Vlerësimi gjithëpërfshirës	19
A13 – Vlerësimi ndërkolegjial i orës mësimore	32

Hyrje

Zyra për Sigurim të Cilësisë

Zyra për Sigurim të Cilësisë vepron në kuadër të Administratës Qendrore të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren. ZSC-së ka për qëllim krijimin dhe avancimin e vazhdueshëm të politikave dhe praktikave të universitetit në funksion të ngritjes së cilësisë, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Arsim të Lartë, Standardet e Sigurimit të Cilësisë në Zonën Evropiane, Standardet e Akreditimit/Agjencioni i Akreditimit të Kosovës dhe Rregulloren për Sigurim të Cilësisë.

Epror operativ i ZSC-së është Prorektori për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ngritje të Cilësisë, ndërsa epror administrativ është Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit. Matja e cilësisë bëhet me instrumentet e përfshira në Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, të draftuara nga Komisioni Qendror i Sigurimit të Cilësisë dhe të miratuara në Senat. Raportet e hartuara nga Komisionet e Sigurimit të Cilësisë në nivel të njësive akademike duke përfshirë rekomandimet të cilat dalin nga rezultatet e vlerësimit, me hartimin e raportit përmbledhës, i dërgohen menaxhmentit me ç’rast njoftohen dekanët dhe udhëheqësit administrativ (palët e interesit) me qëllim të planifikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm dhe palët tjera të interesit. Raporti përmbledhës është publik, në uebfaqen e universitetit.

Pyetësorët A1, A2, A3, A4, A5, A6 dhe A13 lansohen dy herë në vit, përderisa pyetësorët tjerë lansohen në fundvit. Pyetësori A8 dhe A12 janë vazhdimisht në proces gjatë çregjistrimit dhe diplomimit të studentëve. Pyetësorët janë anonim dhe sigurojnë konfidencialitet të plotë. Performanca e stafit akademik përmban pesë shtylla të vlerësimit nga pyetësorët A1, A2, A3, A4 dhe A5, rezultatet e të cilave pasqyrojnë performancën e stafit për semestër dhe vit akademik. Stafi akademik njoftohet për performancën e realizuar në mënyrë të vazhdueshme (çdo semestër).


A1 – Vlerësimi i mësimdhënësit/asistentit nga studentët

Pyetësi është i destinuar për studentët e nivelit bachelor dhe master. Pyetësi përfshin 17 pyetje për mësimdhënësit dhe 16 pyetje për asistentët dhe një pyetje të hapur. Vlerësimi bëhet nga 1-5. Pyetësi përfshin pyetjet lidhur me:


- Mësimdhënien,
- Raportin me studentë,
- Kodin etik.

Pyetësi është hartuar në mënyrë që të sigurojë informacione rreth zbatimit të plotë të syllabusit, zhvillimin profesional, metodat e mësimdhënies, menaxhimin e kohës, kënaqshmërinë me vlerësimin, gatishmërinë për ofrimin e konsultimeve, sjelljen e mësimdhënësve/asistentëve.


Pyetësi realizohet dy herë në vit, në fund të semestrit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit. Mësimdhënësit dhe asistentët njoftohen për performancën e tyre, si dhe në kohë reale mund t'i shohin rezultatet e pyetësoreve në sistemin elektronik në profilin e tyre. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Pyetësit i janë përgjigjur 8593 herë studentët për semestrin veror. Rezultatet e pyetësit janë të kënaqshme me vlerësim 4,37 në nivel universiteti, nga vlerësimi i plotë pesë-shkallësh. Më poshtë janë paraqitur rezultatet për secilën pyetje në mënyrë grafike.




P1: Në fillim të semestrit, mësime/ndërrësorja ka prezantuar syllabusin/përmbajtjen e lëndës dhe metodat e vlerësimit.




P2: Mësime/ndërrësorja ka qenë i rregullt në ligjerata.




P3: Mësime/ndërrësorja ka shoqëruar ligjëratat me shembuj dhe ilustrime të cilat ndihmojnë në kuptimin e përmbajtjes së ligjëratës.




P4: Mësimdhënësi/ja ka përdorur teknologjinë bashkëkohore të mësimdhënies (p.sh. projektorët, internetin, simulatorët).




P5: Mësimdhënësi/ja ka treguar gatishmëri për t'iu përgjigjur pyetjeve të studentëve dhe ka treguar kompetencë për lëndën.




P6: Mësimdhënësi/ja gjatë ligjëratave ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë.




P7: Mësimdhënësi/ja i jep rëndësi pjesëmarrjes së studentëve në ligjërata.




P8: Mësimdhënësi/ja ka përdorur burime/literaturë bazike dhe burime shtesë në mësimdhënie.




P9: Mësimdhënësi/ja ka integruar konceptet teorike dhe praktike për lëndën (nëse aplikohen ushtrimet).




P10: Sa është harmonizuar përmbajtja e ligjëratave me ushtrimet? (nëse aplikohen ushtrimet)




P11: Mësimdhënësi/ja e ka menaxhuar mirë kohën gjatë ligjëratave.




P12: Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi.




P13: Sa ka shprehur gatishmëri mësime dhënë/ja në ofrimin e konsultimeve jashtë orarit të ligjëratave?




P14: Mësime dhënë/ja është sjellur në përputhje me kodin etik.




P15: Sa ju ka ofruar mësime dhënë informacione për trendet aktuale që lidhen me lëndën?




P16: Sa efektiv ka qenë mësime dhënësi gjatë ligjërimit?




P17: Si e vlerësoni mësime dhënësin/en në përgjithësi?




P18: Asistenti/ja ka qenë i rregullt në ushtrime.




P19: Asistenti/ja ka qenë i përgatitur dhe ka treguar kompetencë për lëndën.




P20: Sa i është përmbajtur asistenti/ja syllabusit/përmbajtjes së lëndës?




P21: Asistenti/ja gjatë ushtrimeve ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë.




P22: Asistenti/ja i jep rëndësi pjesëmarrjes së studentëve në ushtrime.




P23: Asistenti/ja ka përdorur burime të mjaftueshme në ushtrime.




P24: Asistenti/ja ka kontribuar në integrimin e koncepteve teorike dhe praktike për lëndën. (nëse aplikohen ushtrimet)




P25: Sa janë të harmonizuara ligjëratat me ushtrimet?
(nëse aplikohen ushtrimet)




P26: Asistenti/ja e ka menaxhuar mirë kohën gjatë ushtrimeve.




P27: Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi.




P28: Sa ka shprehur gatishmëri asistenti/ja në ofrimin e konsultimeve jashtë orarit të ushtrimeve?




P29: Asistenti/ja është sjellur në përputhje me Kodin etik.




P30: Sa ka përdorur prezantime (me slajde) gjatë ligjërimit?




P31: Sa ju ka ofruar asistenti/ja informacione për trendet aktuale që lidhen me lëndën?



P32: Sa efektiv ka qenë asistenti/ja gjatë ushtrimeve?



P33: Si e vlerësoni asistentin/en në përgjithësi?




A2 – Vlerësimi ndërkolegjial



Pyetësi është i destinuar për stafin akademik. Vlerësimi ndërkolegjial realizohet dy herë në vit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik. Pyetësi është lansuar për të gjitha njësitë akademike. Pyetësi është i ndarë në 4 nivele të cilat vlerësohen nga 1-5.



- Bashkëpunimi kolegjial,
- Komunikimi kolegjial,
- Marrëdhëniet ndërpersonale,
- Sjellja etike kolegjiale.

Pyetësi ka për qëllim identifikimin e përparësive dhe nevojave për përmirësim në marrëdhëniet ndërkolegjiale. Mësimdhënësit njoftohen për performancën e tyre çdo semestër përfshirë edhe vlerësimin ndërkolegjial. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Fakulteti Ekonomik ka një mesatare të vlerësimit ndërkolegjial prej 3,88, Fakulteti i Edukimit 4,54, Fakulteti i Filologjisë 3,87, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike 4,56, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit 4,39 dhe Fakulteti Juridik 3,83. Në nivel universiteti, mesatarja e vlerësimit ndërkolegjial është 4,18 nga 5.










A3 – Raporti i vlerësimit nga dekani

Pyetësi është i destinuar për dekanët për vlerësimin e stafit akademik të njësive akademike dhe realizohet dy herë brenda vitit dhe është një ndër shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik. Pyetësi është ndarë në 3 shtylla/kategori për vlerësim, si dhe një pyetje të hapur me ç'rast vlerësohet:

- Vijueshmëria e rregullt (10%),
- Mbajtja e rregullt e provimeve dhe konsultimeve (5%),
- Sjellja etike me studentë dhe kolegë (5%).

Qëllimi i pyetësit është vlerësimi nga udhëheqësi i njësive akademike me qëllim të sigurimit të informacioneve për përmirësim. Mësimdhënësit në kohë reale njoftohen për vlerësimin e tyre nga dekani në sistemin elektronik/profilin e tyre. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.





A6 – Vlerësimi gjithëpërfshirës

Pyetësi është i destinuar për studentët. Vlerësimi gjithëpërfshirës është hartuar me qëllim që të sigurojë një informacion gjithëpërfshirës nga studentët. Pyetësi është i ndarë në 4 shtylla/kategori për vlerësim me 32 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura.

- Kategoria e programit studimor përmban 7 pyetje,
- Kategoria e fakultetit, qeverisjes dhe shërbimeve për studentë përmban 7 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur,
- Kategoria për shërbimet administrative të universitetit përmban 3 pyetje,
- Kategoria e bibliotekës përmban 7 pyetje,
- Kategoria e infrastrukturës përmban 4 pyetje,
- Kategoria e aktiviteteve jashtë kurrikulare përmban 4 pyetje.

Pyetjet kanë qëllim të ofrojnë outpute në aspektet:


- Sa i përmbush programi studimor pritshmëritë e studentëve,
- Mjaftueshmërinë e lëndëve zgjedhore,
- Motivimin për punë kërkimore-shkencore të studentëve,
- Programi studimor dhe punësimi,
- Korrelacioni menaxhment-student,
- Funksionaliteti i fakulteteve, shërbimeve studentore,
- Raportet ndërpësonale,
- Zgjedhjet studentore,
- Mobiliteti,
- Informimi, shërbimet e IT-së,
- Biblioteka, qasja, literatura, shërbimi,
- Infrastruktura, sallat, kabinetet, pajisjet laboratorike, higjiena.

Vlerësimi bëhet nga 1-5. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Në total 2580 respondentë i janë përgjigjur pyetësorit.


- 439 respondentë nga Fakulteti i Edukimit
 - 161 respondentë nga Programi Fillor
 - 167 respondentë nga Programi Parafillor
 - 39 respondentë nga Programi Fillor – Boshnjakisht
 - 17 respondentë nga Programi Parafillor – Boshnjakisht
 - 27 respondentë nga Programi Fillor – Turqisht
 - 28 respondentë nga Programi Parafillor – Boshnjakisht
- 588 respondentë nga Fakulteti Ekonomik
 - 239 respondentë nga drejtimi Administrim Biznesi
 - 253 respondentë nga drejtimi Menaxhment Ndërkombëtar

- 10 respondentë nga drejtimi Kontabilitet dhe Auditim – Master
- 86 respondentë nga drejtimi Administrim Biznesi – Master
- 527 respondentë nga Fakulteti Filologjik
 - 134 respondentë nga drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe,
 - 239 respondentë nga drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Angleze
 - 154 respondentë nga drejtimi Gjuhë Gjermane
- 160 respondentë nga Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
 - 88 respondentë nga drejtimi Agrobiznes
 - 49 respondentë nga drejtimi Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit
 - 23 respondentë nga drejtimi Menaxhim në Agrobiznes
- 469 respondentë nga Shkencat Kompjuterike
 - 113 respondentë nga drejtimi Dizajn i Softuerit
 - 237 respondentë nga drejtimi TIT
 - 36 respondentë nga drejtimi Shkenca Kompjuterike – Master
 - 63 respondentë nga drejtimi TIT – Boshnjakisht
 - 20 respondentë nga drejtimi TIT – Turqisht
- 397 respondentë nga drejtimi Juridik


Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësorët.




P1: Programi studimor i përmbush pritjet e studentëve.




P2: Programi studimor ofron numër të mjaftueshëm të lëndëve zgjedhore.




P3: Puna praktike zhvillohet rregullisht dhe sipas planifikimit.




P4: Studentët motivohen për t'u përfshirë në punën kërkimore në bashkëpunim me mësuesin.




P5: Studentëve i ofrohen shërbime dhe këshilla nga bartësit e programit studimor.




P6: Studentëve i ofrohet mësimi elektronik (ligjëratat online).




P7: Programi studimor i ofron studentëve mundësinë e punësimit pas përfundimit të studimeve.




P8: Menaxhmenti i fakultetit (dekani, prodekani, shefi i programit) është i hapur për vërejtje, sugjerime dhe kërkesa të studentëve.




P9: Fakulteti ka staf të mjaftueshëm dhe funksionon në mënyrë efikase.




P10: Shërbimet e administratës së fakultetit janë të kënaqshme.




P11: Fakulteti ofron kushte infrastrukturore të kënaqshme (p.sh. ndërtesa, klasa, laboratore, hapësira sociale).




P12: Raportet mesimdhënës-student janë miqësore dhe motivuese.




P13: Studentët marrin pjesë në zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve të Parlamentit Studentor (PS).




P14: Studentëve i ofrohen mundësi për mobilitet dhe intership jashtë vendit (p.sh. Erasmus).




P15: Administrata ofron shërbime efikase për studentët.




P16: Shpalljet dhe njoftimet për studentë jepen me kohë.




P17: Personeli i IT-së ofron shërbime efikase për studentët.




P18: Biblioteka ka personel të mjaftueshëm dhe profesional.




P19: Biblioteka punon me orar të përshtatshëm për studentë.




P20: Biblioteka është e pasur me literaturë të mjaftueshme.




P21: Biblioteka ofron qasje të mjaftueshme dhe efikase në bibliotekat elektronike.




P22: Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme në gjuhët e komuniteteve (Boshnjakisht, Turqisht).




P23: Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme në gjuhët e huaja. (Anglisht, Gjermanisht).




P24: Biblioteka ofron qasje dhe shërbime të kënaqshme për personat me nevoja të veçanta.




P25: Në Fakultet/Universitet kemi hapësira të mjaftueshme.




P26: Sallat e mësimit ofrojnë kushte të kënaqshme për mësim.




P27: Mirëmbajtja e hapësirave të Fakultetit/Universitetit është në nivelin e duhur.




P28: Kabinetet e informatikës janë të pajisura me kompjuterë dhe IT-ja pajisje dhe të njëjtat janë në dispozicion për studentët.




P29: Studentët marrin pjesë në planifikimin dhe vendimmarrjen e aktiviteteve jashtëkurrikulare.




P30: Studentët kanë qasje në qendrat rekreative, argëtuese dhe sportive brenda ose jashtë Universitetit.



P31: Studentëve u ofrohen kushte të kënaqshme për kalimin e kohës së lirë në Fakultet/Universitet.



P32: Studentët janë të informuar dhe përkrahen nga Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA).



A13 – Vlerësimi ndërkolegjial i orës mësimore

Vlerësimi ndërkolegjial i orës mësimore realizohet dy herë në vit, çdo semestër. Vëzhgimi ndërkolegjial bëhet në lëndën apo lëminë e njëjtë ose të përafërt. Qëllimi i pyetësorit është:

- Të identifikohen pjesët e ligjëratës që e përmirësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies,
- Të derivohen sugjerimet lidhur me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies nga vëzhgimet, idetë dhe objektivat gjatë procesit të vëzhgimit.

Fakulteti Ekonomik: Në Fakultetin Ekonomik janë kryer 13 vëzhgime kolegjiale.

Fakulteti i Edukimit: Në Fakultetin e Edukimit janë kryer 6 vëzhgime kolegjiale.

Fakulteti i Filologjisë: Në Fakultetin e Filologjisë janë kryer 4 vëzhgime kolegjiale.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike: Në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike janë kryer 7 vëzhgime.

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit: Në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit janë realizuar 9 vlerësime ndërkolegjiale.